



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Draft

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 22/06/2021
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 04/532

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2022 - 2024

Malishevë, Qershor 2021

Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore, përmban një detyrim për programet-nenprogramet buxhetore të Komunës të kerkuara nga Qarkorja Buxhetore Komunale nr.2022/1 për Komunitat e Kosoves e leshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektoreve të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve në Komunë dhe shpërndarjen e të hyrave Komunale për periudhën 2022-2024.

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2022-2024, do të hartohet, ndryshohet, plotësohet dhe do të aprovohet sipas procedurave të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe do të kalojë nëpër katër faza si vijon:



3. Profili i shkurtër socio-ekonomik i komunës

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, respektivisht në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Territori i komunës përfshinë një sipërfaqe prej 306.48 Km² (2.8% të territorit të Kosovës), dhe shtrihet në një gjerësi prej 42° dhe 28'41" dhe gjatësi prej 20° 44'33". Kufizohet me komunat e Drenasit, Lipjanit, Suharekës, Rahovecit dhe Klinës.

Konfiguracioni i përshtatshëm i terrenit i mundëson komunës që të ketë lidhje të mira të komunikacionit me të gjithë vendin. Me shumicën e qyteteve kryesore të Kosovës lidhet brenda një distance prej rreth 40-55 km - Gjakovë 40 km, Prizren 44 km, Prishtinë 49 km, Pejë 52 km, Ferizaj 56 km, Mitrovicë 75 km, Gjilan 80 km. Sa i përket lidhjeve ndërshtetërore, kalimi i autostradës Durrës-Merdarë përmes territorit të komunës e vë Malishevën në pozitë të volitshme për lidhje rrugore rajonale ndërkombëtare. Autostrada Durrës-Merdarë i mundëson lidhje të lehtë dhe të shpejtë me Republikën e Shqipërisë dhe portin e Durrësit ndërsa planet për vazhdimin e mëtutjeshëm të kësaj autostrade, si dhe ndërtimi i autostradës së re për Han të Elezit do ti mundësojnë lidhje cilësore dhe të shpejta me shtetet dhe korridoret rajonale të transportit.

Përveç avantazheve të lidhjeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, pozita e komunës së Malishevës ofron përparësi edhe sa i përket vlerës dhe burimeve natyrore. Hapësira komunale që kufizohet me terrenet kodrinore në pjesën lindore (e cila është e kufizuar me Drenasin, Lipjanin dhe Suharekën) dhe në Jugperëndim (që kufizohet me Rahovecin), dhe shtrirja e sipërfaqeve të rrafshëta në qendër, ofrojnë një larmi të përmbajtjeve sa i përket potencialeve bujqësore, mjedisore dhe biodiversitetit. Një numër relativisht i madh i burimeve natyrore dhe kulturore që ky territor i posedon krijojnë një trashëgimi të larmishme dhe me vlerë.

Si një aset i veçantë duhet të ceket Ujëvara panoramike e Mirushës që ndodhet në kufirin e komunës së Klinës dhe Malishevës. Për shkak të vlerave që ka kjo zonë është shpallur Monument Natyror me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës", me një sipërfaqe prej 598.4 ha, i cili shtrihet në komunat e Malishevës, Klinës dhe Rahovecit.

Sipas regjistrimit të fundit (2011), në Komunën e Malishevës jetojnë 54.613 banorë, që përbëjnë 3.14% të banorëve të Kosovës. Prej numrit të gjithëmbarshtëm të banorëve në komunë, 3395 (6.22%) jetojnë në zonën urbane, që është dukshëm më e ulët se mesatarja e Kosovës prej 38%.

4.1. Objektivat e kornizës afatmesme buxhetore

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022 – 2024, planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në "Buxhetin e programeve" dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misionëve të programeve. KAB-ja komunale 2022–2024, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2022/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Me Kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024 të Komunës së Malishevesë, synohet të arrihen këto objektiva:

- Zhvillimin ekonomik;
- Planifikimin urban dhe rural;
- Shfrytëzimin e tokës;
- Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- Formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, drenazheve, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;
- Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Ofrimin e për kujdesit publik primar shëndetësor;
- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin fëmijnor, përkujdesin për të moshuarit;
- Banimin publik;
- Shëndetësinë publike;
- Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Aktivitetet kulturore dhe të lira.

Tabela 1. Pagat dhe Meditjet

Kodi i prog.	Programet buxhetore	Buxheti aktual	Parashikimet			
		2021	2022	2023	2024	
160	Zyra e Kryetarit	38.340	38.600	36.600	36.600	
169	Zyra e Kuvendit Komunal	117.351	118.900	118.900	118.900	
163	Administrata dhe Personeli	318.936	322.100	322.100	322.100	
175	Buxheti dhe Financat	135.038	128.200	128.200	128.200	
180	Shërbimet Publike dhe Emergjencia	194.016	196.600	196.600	196.600	
195	Zyra për Komunitete	5.999	6.200	6.200	6.200	
470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural	116.653	131.600	131.600	131.600	
650	Gjeodezia dhe Kadastër	56.944	58.500	58.500	58.500	
660	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	55.290	56.200	56.200	56.200	
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	930.732	956.700	956.700	956.700	
	Kultura, Rinia dhe Sporti	48.464	50.900	50.900	50.900	
75561	Sherbimet sociale	65784	65.500	65.500	65.500	
920	Arsimi dhe Shkenca	6.279.653	6.428.643	6.428.643	6.428.643	
	Gjithsej:	8.363.200	8.558.643	8.558.643	8.558.643	

Duke u bazuar në kornizën në fjalë dhe parametrat tjerë në lidhje me të hyrat dhe të dalurat në periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet që sektorët e komunës do të kenë këto të hyra dhe të dala:

Tabela 2. Buxheti aktual 2021 dhe kufijt buxhetor për periudhën 2022 – 2024

Kategoritë buxhetore	Buxheti	Parashikimet		
	2021	2022	2023	2024
Granti i përgjithshëm	5,505,295	5,593,474	5,841,768	6,123,418

Dokumenti bënë prezantimin e shkurtër lidhur me mënyrën e zotimit të planifikuar të qeverisjes lokale, lidhur me politikat fiskale që ndikojnë në buxhetin e komunës të ndërlidhura me ndryshimet në kufijtë në mes të shpenzimeve operative (pagat+ mëditjet dhe mallrat + shërbimet), si dhe shpenzimeve kapitale, që do të reflektohen në përmirësimin e infrastrukturës publike në njërin anë, si dhe në sigurimin e kushteve të mundshme në drejtim të rritjes së arkëtimit të taksave, ngarkesave dhe tatimit në pronë. Të gjitha këto do të jenë si rezultat i ngritjes dhe promovimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë së shpenzimeve të parasë publike.

6.Të hyrat vetanake komunale dhe parashikimet afatmesme 2022-2024

Të hyrat komunale të komunes realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushteti Lokal, Rregullores mbi Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë lloje të ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë: Tatimi në pronë, Taksat nga ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe taksat komunale për leje ndërtimi të cilat të hyra duhet të shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që iu kthehen qytetarve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale

Të hyrat vetanake të komunës përbehen nga:

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- Taksat për regjistrimin e veturave
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për shërbime kadastrale
- Taksa për përcaktimin e hipotekës
- Taksa për qertifikata (lindjes, kurorizimit, vdekjes),
- Të hyrat nga qiraja e objekteve komunale
- Të hyra tjera.

Për periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet rritja e të hyrave duke u bazuar në këta faktorë:

- ✓ ekzekutimi i borxheve të bartura,
- ✓ implementimi i instrumenteve ligjore për zbatim,

Tabela 3. Planifikimi i të hyrave vetanake komunale, 2022-2024

Burimi i të hyrave	2021	2022	2023	2024
Totali i buxhetit	15,218,977	15,655,757	16,569,634	17,382,725
Granti qeveritar	14,322,887	14,622,288	15,430,898	16,192,004
Granti i përgjithshëm	5,505,295	5,593,474	5,841,768	6,123,418
Granti për arsim	6,924,921	7,136,143	7,492,950	7,867,597
Granti për shëndetësi	1,892,671	1,892,671	2,096,180	2,200,989
Huamarrja për arsim	0	0	0	0
Huamarrja për shëndetësi	0	0	0	0
Të hyrat vetanake	896,090	1,033,469	1,138,736	1,190,721
Drejtoria për buxhet dhe financa	643,890	769,665	869,938	860,771
Tatimi në prone	341,151	416,965	481,089	510,071
Tatimi në tokë	20,000	220,000	249,249	260,000
Licenca dhe lejet	1,000	1,500	1,600	1,800
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë				
Qiraja nga objektet publike	35,000	38,000	38,500	40,000
Licencat për shërbimet profesionale				
Licencat tjera për afarizëm				
Taksë e paisjeve motorike	21,739	28,200	30,500	32,500
Taksa tjera administrative	45,000	65,000	69,000	16,400
Drejtoria për administratë të përgjithshme	101,700	96,419	95,500	109,000

Drejtoria për bujqësi pylltari dhe ZhR		500	750	1,000
Taksa nga ndërrimi i destinimit të tokës				
Taksa nga licenca e gurthyesve				
Taksa nga shfrytëzimi i pyjeve				
Taksa nga qira e tokës bujqësore				
Taksa administrative për fletëkërkesë		500	750	1,000
Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim		350	500	850
Taksa nga largimi dhe deponimi i automjeteve				
Taksa nga gjobat në trafik				
Taksa nga inspektimi I ambientit				
Taksa administrative për fletëkërkesë		350	500	850
Drejtoria për arsim	30,000	30,000	33,000	50,000
Të hyrat nga qerdhja e fëmijëve	30,000	30,000	33,000	50,000
Të hyrat nga participimi I arsimit joformal				
Taksa administrative për fletëkërkesë				
Drejtoria e shëndetësisë dhe MS	55,000	55,000	55,000	55,000
Të hyrat nga participimi në shëndetësi	55,000	55,000	55,000	55,000
Taksa administrative për fletëkërkesë				
Drejtoria për kulturë, rini dhe sport		1,500	2,000	2,500
Të hyrat nga biblioteka		1.500	2,000	2,500

Ky dokument përfshin tabelën e cila prezanton planifikimin e të hyrave të komunës nga të gjitha burimet , në bazë të fushave kryesore të të hyrave për tri vitet e ardhshme duke prezantuar edhe vitin aktual 2021.

	Grantet Qeveritare	48	322,100	203,700	0	0	0	525,800
	Të hyrat vetanake		0	64,100		0	0	64,100
	Financim nga huamarrja		0	0	0	0	0	0
Administrata		47	315,200	262,300	0	0	0	577,500
	Grantet Qeveritare	47	315,200	198,200				513,400
	Të hyrat vetanake			64,100				64,100
	Financim nga huamarrja							0
Çështjet gjinore		1	6,900	5,500	0	0	0	12,400
	Grantet Qeveritare	1	6,900	5,500				12,400
	Të hyrat vetanake							
	Financim nga huamarrja							
Buxheti dhe financat		21	128,200	36,490	0	100,000	1,109,169	1,373,859
	Grantet Qeveritare	21	128,200	14,500	0	0	773,903	916,603
	Të hyrat vetanake		0	21,990	0	100,000	335,266	457,256
	Financim nga huamarrja		0	0				0
Buxhetimi		21	128,200	36,490	0	100,000	1,109,169	1,373,859
	Grantet Qeveritare	21	128,200	14,500			773,903	916,603
	Të hyrat vetanake			21,990		100,000	335,266	457,256
	Financim nga huamarrja							
Shërbimet Publike		28	196,600	171,004	210,000	0	1,357,072	1,934,676
	Grantet Qeveritare	28	196,600	171,004	210,000	0	1,260,026	1,837,630
	Të hyrat vetanake						97,046	97,046
	Financim nga huamarrja						0	

	Financim nga huamarrja									0	
Arsimi dhe shkenca		1,008	6,428,643	541,895	115,000	70,000	80,605	7,236,143			
	Grantet Qeveritare	1,008	6,428,643	511,895	115,000	0	80,605	7,136,143			
	Të hyrat vetanake			30,000			0	100,000			
	Financim nga huamarrja			0			0	0			
Administrata		6	42,500	0	0		80,605	193,105			
	Grantet Qeveritare	6	42,500	0			80,605	123,105			
	Të hyrat vetanake					70,000		70,000			
	Financim nga huamarrja										
Arsimi parashkollor dhe qerdhet		66	418,000	55,000	0	0	0	473,000			
	Grantet Qeveritare	66	418,000	25,000				443,000			
	Të hyrat vetanake			30,000				30,000			
	Financim nga huamarrja							0			
Arsimi fillor		805	4,994,100	411,695	81,587	0	0	5,487,382			
	Grantet Qeveritare	805	4,994,100	411,695	81,587			5,487,382			
	Të hyrat vetanake							0			
	Financim nga huamarrja			0				0			
Arsimi I mesëm		131	974,043	75,200	33,413	0	0	1,082,656			
	Grantet Qeveritare	131	974,043	75,200	33,413			1,082,656			
	Të hyrat vetanake										

Procesi buxhetor do të shërben si mjet për ofrimin e politikave të drejta financiare me prioritet të arsyeshme, në interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Tabela 5. Buxheti sipas kategorive Buxhetore

Kategoritë buxhetore		Buxheti	Parashikimet			
		2021	2022	2023	2024	
1.	Paga dhe mëditje	8,363,200	8,591,643	8,791,643	8,891,643	
2.	Mallra dhe shërbime	1,529,525	1,679,730	1,679,730	1,679,730	
3.	Shpenzime komunale	455,000	455,000	455,000	455,000	
4.	Subvencione dhe transfere	400,000	400,000	400,000	400,000	
5.	Shpenzime kapitale	4,153,031	4,529,384	5,134,386	5,844,665	
	TOTALI:	14,900,756	15,655,757	16,460,759	17,268,406	
	Nr. i të punësuarve:	1297	1297	1297	1297	

Buxheti si total per vitin 2022 sipas Qarkorës buxhetore është rritur për 436,780 € ose 2.87%, në krahasim me vitin me vitin 2021. Ndërkaq, të hyrat vetanake janë rritur për 137,379 €, ose për 1.15%, në krahasim me vitin 2021.

- ❖ **Pagat dhe Meditje-** Pjesëmarrja e kataegorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, në këtë periudhë, pritet të mbetet në nivel përafërsisht të njëjtë, vetëm nëse hynë në fuqi ligji i pagave atëherë do të ketë ndryshime.
- ❖ **Mallrat dhe shërbimet-** Kategoria e shpenzimeve për mallra shërbime, në vitin 2022, nuk ka ndryshime per shkak te buxhetit te zvogluar në krahasim me buxhetin e vitit 2021.
- ❖ **Shpenzimet komunale-** Kjo kategori i atribuohet rritjes së shpenzimeve për pagesën e mbeturinave, për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, pagesat për ndriçimin publik, pastrami dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, objekteve shëndetësore, sportive etj.
- ❖ **Subvencionet dhe transferet-** Në vitin 2022, komuna e Malishevës, nga kjo kategori do të subvencionoj bujqësinë, shëndetësinë, arsimin, kulturën, rininë, sportin dhe bursat për student.

Tabela 7. Planifikimi për vitin 2022, Nivelet e pagave në organizatën buxhetore

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201 - 400	121	52	280,000	69	832,560
401 – 600	1,071	921	6,724,083	150	936,000
600+	105	102	795,600	3	23,400

8.Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Komuna ka të përgatitur dhe të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal 2015-2023⁺ dhe në të është cekur **vizioni për të ardhmen:** *“Komuna e Malishevës do të këtë infrastrukturë të përmirësuar fizike dhe mjedis të mbrojtur natyror, ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, bujqësi intensive, rritje të punësimit, ngritje të nivelit të arsimit dhe të edukimit sipas nevojave të tregut, shërbime cilësore publike, shëndetësore dhe administratë lokale më efikase”.*

Komuna në tri vitet e ardhshme do të këtë këto objekte për realizim dhe njëherit do të financojë tërësisht apo pjesërisht ato si vijon:

Objektivat:

- Shtimi i efikasitetit në punë që ndikon në zhvillimin ekonomik:
 - përmirësimi i kushteve për shërbime publike,
 - përmirësimi i efikasitetit në shpenzimet e parave publike,
 - shfrytëzimi maksimal i burimeve të mundshme,
 - kryerja e punëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.
- Rritja e shpejtë e të ardhurave :
 - shkalla më e lartë e arkëtimit të tarifave dhe ngarkesave
 - insistimi në zgjerimin e fushave kryesore për të hyrat,
 - ngarkesa të reduktuara me tarifa të zgjeruara,
- Sigurimi i disiplinës financiare :
 - ✓ pajtueshmëri me politiken financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet,
 - ✓ ekzistenca e kontrolleve interne,
 - ✓ transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
 - ✓ analiza e shpenzimeve,
 - ✓ evidencë e duhur financiare dhe kontabël,
 - ✓ inventarizim i duhur dhe menaxhim i pronës,
 - ✓ përmirësim i politikës dhe procedurave të prokurimit,
 - ✓ zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik,

10. Korniza e performances së shpenzimeve

Indikatorët e performancës së shpenzimeve janë të hartuar konform fushave dhe objektivave prioritare të komunës për periudhën afatmesme 2022-2024. Njësitë matëse të idikatorëve janë të ndryshëm të cilat ndërlidhen në mes të idikatorëve sasiore dhe cilësore.

Korniza e performancës së shpenzimeve pasqyron ndarjen e synimeve në objektiva, dhe në secilën nga objektivat paraqiten indikatorët e performancës të cilët mundësojnë matjen e realizimit të objektivit përkatës. Përveq synimeve strategjike, objektivave përkatës dhe idikatorëve matës, janë pasqyruar edhe vlerat buxhetore të shpenzimeve për realizimin e këtyre synimeve. Vlerat e paraqitura në tabela përfshijnë kategorinë ekonomike- shpenzime kapitale, të planifikuara edhe në kategoritë tjera ekonomike të lidhura me këto synime.

1. Zhvillimi ekonomik

Objektivat strategjike	Indikatorët për matjen e performancës në drejtim të përmbushjes së objektivave	Viti bazë 2021	Parashikuar 2022	Parashikuar 2023	Parashikuar 2024
Promovimi dhe mbështetja e bizneseve	Nr.i NVM përfituese nga përmirësimi i infrastrukturës rrugore, ligjore dhe lehtësimi i procedurave administrative rreth regjistrimit të bizneseve	1600	1630	1660	1700
Zhvillimi i bujqësisë intensive	Nr.i fermerëve (ekonomike familjare) që përfitojnë nga projektet e bujqësisë	150	180	220	250
	Rritja e sipërfaqeve bujqësore në sera (në %)	15	20	25	30
	Rritja e rendimenteve bujqësore (% për ha)	20	25	30	35
Synimi (Objekti strategjik)		Burimet e financimit – Buxhetimi (në 000 €)			
Zhvillimi ekonomik		200	500	550	650
Objekti 1- Promovimi dhe mbështetja e bizneseve	-		200	250	300
Objekti 2- Zhvillimi i bujqësisë intensive		200	250	300	350

Në synimin e parë, janë të identifikuar dy objektiva me katër indikatorë matës të performancës së shpenzimeve drejt përmbushjes së objektivave, të cilat kanë të bëjnë me sektorin e zhvillimit të bizneseve dhe të bujqësisë.

Në synimin e dytë, janë të identifikuar katër objektiva me katërmbdhjetë indikatorë matës të performancës së shpenzimeve drejt përbushjes së objektivave, të cilat kanë të bëjnë me sektorin e urbanizimit dhe shërbimeve publike.

3. Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit

Objektivat strategjike	Indikatorët për matjen e performancës në drejtim të përbushjes së objektivave	Viti bazë 2021	Parashikuar 2022	Parashikuar 2023	Parashikuar 2024
Përmirësimi i infrastrukturës shkollore	Nr. i nxënësve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës shkollore	11646	11646	11646	11646
	Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore (në m ²)	40000	40000	40000	40000
	Përfshirja e nxënësve në arsimin e obligueshëm	99	99	99	99
Synimi (Objektivi strategjik)		Burimet e financimit – Buxhetimi (në 000 €)			
Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit					
Objektivi 1- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore		470	420	420	420
		470	420	420	420

Në synimin e tretë, është identifikuar një objektivi me tre indikatorë matës të performancës së shpenzimeve drejtë përbushjes së objektivit, i cili të bëjë me sektorin e përmirësimit e cilësisë arsimit.

4. Ngritja e nivelit të shëndetësisë primare

Objektivat strategjike	Indikatorët për matjen e performancës në drejtim të përbushjes së objektivave	Viti bazë 2021	Parashikuar 2022	Parashikuar 2023	Parashikuar 2024
Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF dhe QMF (ngritja e mirëqenjes sociale)	Nr. i familjeve të ndihmuara me mjete financiare (familjet pa të ardhura)				
	Nr. i familjeve të varfëra që përfitojnë nga komuna ndihma shëndetësore				
	Nr. i qendrave mjekësore me infrastrukturë të rregulluar dhe të pajisura me aparatë mjekësore	16	16	16	16
	Nr. i pacientëve që kanë nevojë për hemodializë				
	Nr. i pacientëve me gjendje të rëndë ekonomike që përfitojnë barna				
Norma banorë/mjek		1500	1300	1200	1000
Synimi (Objektivi strategjik)		Burimet e financimit-Buxhetimi (në 000)			
Ngritja e nivelit të shëndetësisë primare		420	1320	1330	1330

Pasqyrë tabelare e shpërndarjes së buxhetit nga shpenzimet kapitale, mallërat dhe shërbimet, ndërmjet Synimeve- Objektivave të komunës.

	Burimet e financimit – Buxhetimi (në 000)			
	2021	2022	2023	2024
Synimi (Objektivi strategjik)				
Zhvillimi ekonomik				
Synimi (Objektivi strategjik)	200	250	300	350
Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe mbrojtja e mjedisit				
Synimi (Objektivi strategjik)	2795	3340	4100	4100
Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit				
Synimi (Objektivi strategjik)	470	420	420	420
Ngritja e nivelit të shëndetësisë primare				
Synimi (Objektivi strategjik)	420	1320	1330	1330
Shërbime efikase për qytetarët e komunës				
Synimi (Objektivi strategjik)	50	65	80	100

Drejtorja për Buxhet dhe Financa

Drejtori

Valon Mazreku

